**AKTI I THEMELIMIT**
**DHE**
**STATUTI**
**I**
**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**
**"I.C. ALBANIAN REAL ESTATE GROUP" Shpk**

## KAPITULLI I
## Emri,forma,selia,kohezgjatja

**Neni 1 Data e themelimit dhe Emri**

1.1 Me efekt nga data **25/11/2023** themelohet shoqeria **"I.C. ALBANIAN REAL ESTATE GROUP"** (ne vijim "Shoqeria") e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", I cili perfaqeson formen ligjore te saj, si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuara.

1.2 Ortaket e Shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.

1.3 Ne te gjithe dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri I saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:

1.3.1 Fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "Shpk"
1.3.2 Numri I identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj
1.3.3 Adresa e regjistruar
1.3.4 Pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
1.3.5 Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise

**Neni 2 Forma Ligjore**

2.1 Shoqeria eshte nje entitet Shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me ligjin Nr.9910, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji I Shoqerive").

**Neni 3 Ortaket e Shoqerise**

Ortaket e shoqerise jane si meposhte:

**Z.ANTONIO COPPOLA**, i biri i Ernesto dhe i Vincenza shtetas italian, lindur me 25.07.1970 ne Castellammare di Stabia, dhe banues ne Castellammare di Stabia, VIA PETRARO, 81-MP. T, i pajisur me Karte Identiteti Italiane me Nr.CA63674BW dhe Nr.239008, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar,
**Z.GIANLUIGI IZZO**, i biri Pio Rosario, dhe Evelina, shtetas italian, lindur me 12/05/1987, shtetas italian, lindur ne Latina dhe banues ne TERRACINA, Via SS.148 Pontina KM 101,300 N.113, me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti italiane me Nr.AU 3122404, ne cilesine e Ortakut te Shoqerise.
**Znj.EVELINA COPPOLA** e bija e Ernesto dhe e Vincenza, shtetase italiane, lindur me 10.09.1965 ne Castellammare di Stabia ,dhe banuese ne TERRACINA, VIA MARCONI, N.26, Frosinone, e njohur dhe e pajisur me Karte Identiteti Italiane me numr personal AX7833462 , dhe Kod Fiskal CPPVLN65P50C129L, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, e cila me Prokure te Posacme Nr.249281 repertori te redaktuar me date 15/11/2023 prane Notere Annamaria

Ortolan e regjistruar prane Kolegjit te Distriktit Noterial te Frosinones, te vulosur me Vule Apostille dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuar perfaqesohet nga **Z.Antonio Coppola** i pajisur me Karte Identiteti Italiane me Nr.CA63674BW dhe Nr.239008.

**Znj.VINCENZA FRINO**, e bija e Vincenzo, shtetase italiane, lindur me 03/08/1937 ne Castellammare di Stabia dhe banuese ne Via Petraro, B1-M P. T Castellammare di Stabia(NA), me zotesi te plote per te vepruar, e pajisur me Karte identiteti Italiane me Nr.CA54334BA dhe Nr.776046, me Kod Fiskal FRNVCN37M43C129B, me zotesi te plote per te vepruar, e cila me Prokure te Posacme Nr.249281 repertori te redaktuar me date 15/11/2023 prane Notere Annamaria Ortolan e regjistruar prane Kolegjit te Distriktit Noterial te Frosinones, te vulosur me Vule Apostille dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuar, perfaqesohet nga **Z.Antonio Coppola** i pajisur me Karte Identiteti Italiane me Nr.CA63674BW dhe Nr.239008.

**Neni 4 Selia**
Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:

**Lagjja Nr.9, Rruga " Aleksander Goga", Zona Kadastrale 8512, Pallati Star 1392, H.5, Durres, Shqiperi.**

Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi Brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

**Neni 5 Kohezgjatja**
Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pacaktuar.

## KAPITULLI II

**Neni 6 Objekti I shoqerise**
Objekti aktivitet I Shoqerise do te jete te kryej cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa me poshte:

**Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme, shitje-blerje pasuri te paluajtshme, Qiradhenie pasuri te tundeshme e patundeshme, Sherbime imobiliare, administrim dhe menaxhim te pronave ne teresi.**

Per te arritur qellimin e objektit te shoqerise, ajo mund të kryejë të gjitha transaksionet industriale, komerciale dhe financiare jo me publikun, me pasuri të luajtshme dhe pasuri të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme, me përjashtimin e shprehur të atyre që rregullohen me ligje të veçanta. Shoqeria gjithashtu do të jetë në gjendje të japë garanci, dhe përkrahje për të garantuar detyrimet e veta dhe të supozuara nga palët e treta për atë shoqeri, duke përfshirë marrjen e interesave dhe investimeve në kompani të tjera dhe / ose konsorcium të kompanive që kanë objekte të ngjashme, apo të lidhura me te. Shoqeria gjithashtu mund të kërkojë të gjitha financimet dhe / ose kontributet e kërkuara nga ligjet në fuqi për arritjen e qëllimit të Saj.

**Neni 7 Ndryshime**
Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

## KAPITULLI III
## Kapitali Themeltar, Kuotat e kapitalit Themeltar

**Neni 8 Kapitali themeltar**

8.1 Kapitali i Shoqerise ne krijim e siper eshte i shprehur ne natyre, ne formen e pasurive te paluajtshme ne territorin e Komunen Castellammare di Stabia, Itali ne emer te zotit **Ernesto Coppola dhe Vincenza Frino, si dhe Izzo Gianluigi** ne komunen Terracina (LT), Via S.S. 148 Pontina, Km 101,300.

Kapitali ne natyre perbehet nga Pasuri te Paluajteshme te vendosura ne Komunen Castellammare di Stabia dhe specifikohen si me poshte ne Regjistrin Kadastral Urban:

1) **Apartament, Via Petraro**: Siperfaqe 100m2, fleta 4 – Parcela 2707, Numer 2 (te ardhura kadastrale 278,89 Euro) = 36,000 Euro
2) **Depo, Via Petraro**: Siperfaqe.7m2, Fleta 4-Parcela 2707 – Numer 3 = 1,050,00 Euro.
3) **Ambjent ne ndertim e siper**: Siperfaqe 100m2, Fleta 4-Parcela 2707-Numer 4 = 5,000 Euro.

**Totali = 42,050 Euro**

Pasuri te Paluajteshme te vendosura ne Komunen Castellammare di Stabia dhe specifikohen si me poshte ne Regjistrin Kadastral te Tokave:

1) Fletë **4**, parcela Toke Nr.2706 me sip. 180 m2 = 900,00 Euro ;
2) Fletë 4, parcela Toke Nr.2708 me sip. 1.178 m2 = 5.900 Euro
3) Fletë 4, parcela Toke Nr.1607 me sip. 417 m2 = 2,900 Euro

**Totali = 9700 Euro**

**TOTALI I = 42,050 Euro + 9700 Euro = 51,750 Euro**

Toka me ndertesen e siperme, objekt vleresimi, ndodhet ne territorin e Komunen Castellammare di Stabia. Kjo pasuri e paluajtshme eshte e vleresuar nga eksperti Scala Ciro, anetar i Kolegjit te Gjeodeteve te Provinces se Napolit ne numurin 5606 dhe me zyre ne Castellammare di Stabia, u porosit nga znj. Evelina Coppola, e lindur ne Castellammare di Stabia me 10/09/1965, perkthyer nga Arda Grucka, perkthyese e akredituar prane Ministrise se Drejtesise.

I. Kapitali ne natyre perbehet nga Pasuri te Paluajteshme te vendosura ne Komunen Terracina (LT), Via S.S 148 Pontina, Km 101,300 dhe te dalluara ne N.C.E.U ne fleten 190 parcela 646 sub 2-3-4 ndertesat dhe N.C.T fq 190 parcela 78-109-112-456-457-649 Tokat si me poshte:

**1) Banesë e llojit civil në Komunën e Terracina-s (Lt),** Via Strada Regionale 148 Pontina - N.C.E.U. Fletë 190 parcela 646 sub 2 kategoria A/2 klasa 4(banese-verande-bodrum) Kati perdhe : **146,75m2 e barabarte me 88,050 Euro,** (te ardhura kadastrale 712,71 Euro).

**2) Ambjent Magazine në Komunën e Terracina-s (Lt)**

Coppola Antonio

- N.C.E.U. Fletë 190 parcela 646 sub 3(te ardhura kadastrale 777,01 Euro) dhe Sub 4 (te ardhura kadastrale 34,24 Euro) **(Magazine) = 313,50m2 = 62,700 Euro**

**3) Tokat objekt vleresimi, ndodhen ne Komuna e Terracinës (LT) dhe janë identifikuar në Regjistrin kadastral të Tokave, përkatësisht:**
- N.C.T. Fletë 190, **Parcelat 78-109-112-456-457-649 (Toke Bujqesore) = 13.157m2 = 39,471Euro.**

**TOTALI II = 88,050 Euro + 62,700 Euro + 39,471 Euro = 190,221 Euro**

Të gjitha pasuritë e listuara më sipër në lidhje me Komunën e Terracinës (LT) janë treguar dhe vlerësuar me një vlerësim të betuar nga Gjeom. Massimiliano Chiappini i Kolegjit të Gjeodetëve të Frosinone me Nr.2081, me zyre ne Frosinone, Viale tevere 11, 46 , dhe u porosit nga Z. Gianluigi IZZO, i lindur në Latina më 12/05/1987.

**TOTALI I + II i pergjithshem i te gjitha pasurive eshte: 51,750 Euro + 190,221 Euro = 241, 971 Euro**

Vlera Fiskale e prones ne total eshte **241,971 Euro**. Konvertuar me kursin e dates 24.11.2023 te Bankes se Shqiperise ku 1EURO=102,43 LEKE; Vlera ne LEKE e kapitalit ne natyre do te jete **24.785.090 Leke**

**Shoqeria ne krijim e siper do te kete Kapital ne Natyre, ne vleren Leke 24.785.090 te barasvlefshme me 241,971 Euro.**
Pervec kapitalit ne natyre, shoqeria do te kete dhe **kapital ne para, ne vleren LEKE 14.183.585 Leke e barasvlefshme me (138.471 EURO)** qe do te perdoren si kapital i shoqerise plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.

**Kapitali i Shoqerise eshte ne total (ne natyre 24.785.090 Leke dhe para 14.183.585 Leke) eshte e barabarte 38.968.675 Leke (tridhjete e tetemilion e nenteqind e gjashtedhjete e tetemije e gjashteqind e shtatedhjete e pese), plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.**

**Ky kapital eshte i ndare ne 4 (kater) Kuota perkatesisht:**

| | |
|---|---|
| | **5.609.076 leke (kapitali ne para)** |
| **ANTONIO COPPOLA** | **883,105 leke (kapitali ne natyre)** |
| **Perqindja e pronesise ne shoqeri:** | **16,66%, e perbere nga 1 kuote** |
| | |
| **GIANLUIGI IZZO** | **19,484,337 leke (kapitali ne natyre)** |
| **Perqindja e pronesise ne shoqeri:** | **50%, e perbere nga 1 kuote** |
| | |
| | **5.609.076 leke (kapitali ne para)** |
| **EVELINA COPPOLA** | **883,105 leke (kapitali ne natyre)** |
| **Perqindja e pronesise ne shoqeri:** | **16,66%, e perbere nga 1 kuote** |

Coppola Antonio

| | |
|---|---|
| | **2,965,433 leke (kapitali ne para)** |
| VINCENZA FRINO | **3,534,542 leke (kapitali ne natyre)** |
| **Perqindja e pronesise ne shoqeri:** | **16,68%, e perbere nga 1 kuote** |

8.2 Kapitali i Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese,

**Neni 9 Kuotat dhe pjesemarja e Ortakeve ne Kapital te Shoqerise**

9.1. Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

**ANTONIO COPPOLA**, do te njihet si ortaku i shoqerise dhe zoterues i 1 (NJE) kuote, me **16,66%** pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, e me vlere **5.609.076 leke (kapitali ne para)** dhe **883,105 leke (kapitali ne natyre)**

**GIANLUIGI IZZO,** do te njihet si ortaku i shoqerise dhe zoterues i 1 (NJE) kuote, me **50%** pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlere **19,484,337 leke** (kapitali ne natyre).

**EVELINA COPPOLA**, do te njihet si ortaku i shoqerise dhe zoteruese e 1 (NJE) kuote, me **16,66%** pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlere **5.609.076** leke (kapitali ne para) dhe **883,105 leke** (kapitali ne natyre)

**VINCENZA FRINO**, do do te njihet si ortaku i shoqerise dhe zoteruese e 1 (NJE) kuote, me **16,68%** pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlere **2,965,433** leke (kapitali ne para) dhe **3,534,542 (kapitali ne natyre)**

**Neni 10 Zvogelimi ose Zmadhimi I Kapitalit Themeltar**

10.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.

10.2 Zmadhimi I kapitalit mund te realizohet ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

10.3 Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.

10.4 Zmadhimi I kapitalit nuk do te dobesoje pjesen e interest te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, perveese kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim I eili meret me nje shumice prej ¾ e votave.

10.5 Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anullojne ato.

**Neni 11 Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

11.1 Ortaket jane vetem ata te eilet zoterojne kuotat e Shoqerise.

11.2 Cdo Ortak do te kete te drejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Cdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjitshme vendos te shperndaje fitimet,

sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per edo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.

11.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informaeione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne edo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
11.4 Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek edo zoterues i ri per keto Kuota.
11.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervee garaneive dhe huave qe ata realizojne).
11.6 Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

**Neni 12 Transferimi I pjeseve te Kapitalit**
12.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.
12.2 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjithe kuoten e tij Ortaku tjeter do te kete te drejten e parablerjes, kundrejt bleresve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjeter do te rishikoje oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte. Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleres tjeter me emim me te ul et se emimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.

12.3 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

## KREU IV
## Asambleja e Pergjithshme

**Neni 13 Kompeteneat**

13.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i eili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

**Neni 14 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

14.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten I here ne vit.

14.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilaneit vjetor apo raporteve te ndermjetme finaneiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

14.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t' i paraqitet Asamblese, pervee rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

14.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sie rezultojne ne pasqyrat e fundit finaneiare te eertifikuara.

14.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje Raport nga nje Ekspert Kontabel i autorizuar, I pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

14.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi eeshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire eeshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.

14.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

**Neni 15 Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve**

15.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

15.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.

15.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe Ortaket bien dakort.

15.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

15.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentaeionin mbeshtetes do t' u dergohet Ortakeve me poste, korrier, teleeopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe iu eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke I kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim
kundershtite e tyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne administratoreve te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.

15.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne *kapital.*

15.7 Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojn te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise:

(i) Pagesa e cdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;
(ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhje me Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;
(iii) Blerja e cfaredo lloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe sipermarrje;
(iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;
(v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe
(vi) Likuidimi apo shperndarja e Shoqerise.

15.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publie Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen proeedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

15.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

15.10 Administratoret duhet te mbajne proeesverbalet e edo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

**Neni 16 Perjashtimi nga e drejta e votes**

16.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

(i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
(ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
(iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
(iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

16.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

## KREU V
## Administratoret

**Neni 17 Bordi i Administratoreve dhe kompeteneat**

17.1 Shoqeria drejtohet nga nje ose me shume Administratore.

17.2 **ANTONIO COPPOLA**, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, do te emerohet si administrator e Shoqerise per nje periudhe 5-vjecare me te drejte riemerimi.

17.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej **5** vjetesh,me te drejte rinovimi kontrate per periudhe te ngjashme kohore, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte riperteritje te ketij mandati.

17.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin nese maredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

17.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Administratoret me shumice te thjeshte votash.

17.6 Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, eeshtja do te referohet tek Ortaket.

17.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislaeionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht prezent ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimburson Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezeneen e detyrueshme te Adminsitratorit(eve) ne vende qe nuk jane Brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

**Neni 18 Kompeteneat dhe detyrimet**

18.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

i. Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e speeifikuara ne nenin 13.
ii. Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te pereaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
iii. Perfaqesimin e Shoqerise.
iv. Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
v. Pergatitjen dhe firmosjen e bilaneit vjetor, bilaneit te konsoliduar dhe raportit te eurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
vi. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.
vii. Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshm e, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaeme me rendesi te veeante per veprimtarine e Shoqerise.
viii. Kryerjen e detyrave te tjera te eaktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

Coppola Antonio

18.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te eilet emerohen nga Ortaket.

**Neni 19 Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia**

19.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive,
Administratoret detyrohen:

i. te kryejne detyrat e tyre e pereaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veeante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
ii. te ushtrojne kompeteneat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te pereaktuara ne keto dispozita;
iii. te vleresojne me pergjegjesi eeshtjet per te eilat merret vendim;
iv. te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
v. te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

19.2 Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt shoqerise per edo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informaeioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

19.3 Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 19.1 dhe 19.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise edo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e
proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.

19.4 Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:

i. I kthen Ortakeve kontributet;
ii. I paguan ortakeve interesa apo dividente;
iii. I shperndan asete Shoqerise;
iv. lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitetin e saj, kur duhet te kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj.
v. jep hua.

## KREU VI
## Administrimi Financiar I Shoqerise

**Neni 20 Eksperti Kontabel I Autorizuar**

20.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per t'i sherbyer Shoqerise.

Coppola Andrea

20.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KREU VII
## Aktiviteti Shoqerise

**Neni 21 Viti ekonomiko-financiar**

21.1 Viti ekonomiko-finaneiar fillion ne diten e pare te muajit Janar dhe perfundon ne diten e 31-te te muajit Dhjetor te seeilit vit. Viti i pare financiar nis ne daten e themelimit te Shoqerise.

**Neni 22 Mbajtja e Llogarive**

22.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

**Neni 23 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit**

23.1. Fitimi i Shoqerise pereaktohet ne baze te bilaneit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shpemdarja e fitimit do te eaktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

23.2. Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e Legjislaeionit shqiptar per
fondin rezerve te detyrueshem.

23.3. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shpemdaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj
shpemdarje:

i. asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
ii. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem.

23.4. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e eila konfirmon shprehimisht se shpemdarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 23.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shpemdarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete
certifikate.

23.5. Administratoret pergjigjen ndaj Shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KREU VIII
## Modifikimi I Formes Ligjore. Prishja

**Neni 24 Modifikimi I Formes Ligjore**

24.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

24.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

**Neni 25 Prishja e Shoqerise**

25.1 Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne edo kohe;

25.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Bizensit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723 date 3.0 5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligj it nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

## KREU IX
## Te ndryshme

**Neni 26 Largimi I ortakut**

26.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 10I, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

**Neni 27 Te tjera**

27.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**Nenshkrimi I Themeluesve/Ortakeve**

ANTONIO COPPOLA

Coppola Antonio

GIANLUIGI IZZO

EVELINA COPPOLA
Perfaqesuar me Prokure nga
ANTONIO COPPOLA

Coppola Antonio

VINCENZA FRINO
Perfaqesuar me Prokure nga
ANTONIO COPPOLA

Coppola Antonio

Përkthyese
Arda

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
Arda A. Gruçka
TRADUTTORE UFFICIALE
Përkthyese e njohur nga Ministria

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA

V2023011710095664962

PULLE TARIFE
200 LEKE
R.SHQIPERISE

DATE 25/11/2023
NR REP 1724

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25/11 2023(Dymije e njezet e tre), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT: VINCENZA FRINO**, atësia Vincenzo, amësia xxx, shtetase Italiane, lindur në CASTELLAMMARE DI STABIA dhe banues në CASTELLAMMARE DI STABIA, me adresë Via Petraro, B1-M P.T Castellammare Di Stabia, lindur më 03/08/1937, gjendja civile " e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Karte identiteti Italiane me nr. personal CA54334BA, e cila me **Prokure te Posacme ne gjuhen italiane me Nr.249281 repertori te redaktuar me date 15/11/2023** prane Notere Annamaria Ortolan e regjistruar prane Kolegjit te Distriktit Noterial te Frosinones, te vulosur me Vule Apostille dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuar perfaqesohet nga **Z.Antonio Coppola** i pajisur me Karte Identiteti Italiane me Nr.CA63674BW dhe Nr.239008.

**NËNSHKRUES/IT: EVELINA COPPOLA**, atësia Ernesto, amësia Vincenza, shtetas italiane, lindur në CASTELLAMMARE DI STABIA (NA) dhe banues në CASTELLAMMARE DI STABIA (NA), me adresë Frosinone (Fr), Via Casilina Nord, N.169, Itali, lindur më 10/09/1965, gjendja civile "Divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Karte Identiteti Italiane me nr. personal AX7833462, e cila me **Prokure te Posacme ne gjuhen italiane me Nr.249281 repertori** te redaktuar me date 15/11/2023 prane Notere Annamaria Ortolan e regjistruar prane Kolegjit te Distriktit Noterial te Frosinones, te vulosur me Vule Apostille dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuar perfaqesohet nga **Z.Antonio Coppola** i pajisur me Karte Identiteti Italiane me Nr.CA63674BW dhe Nr.239008.

**NËNSHKRUES/IT: ANTONIO COPPOLA**, atësia Ernesto, amësia Vincenza, shtetas Italian, lindur në CASTELLAMMARE DI STABIA (NA) dhe banues në CASTELLAMMARE DI STABIA (NA), me adresë Via Petraro, N.81, Castellammare Di Stabia, Italia, lindur më 25/07/1970, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 239008 dhe nr. personal CA63674BW.

**NËNSHKRUES/IT: GIANLUIGI IZZO**, atësia Pio Rosario, amësia Evelina, shtetas italian, lindur në LATINA (LT) dhe banues në TERRACINA (LT), me adresë Terracina, Via Ss.148 Pontina Km.101,300 N.113, Itali, lindur më 12/05/1987, gjendja civile "celibe", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. AU3122404 dhe nr. personal AU3122404.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, ne prezence te perkthyeses se licensuar te gjuhes Italiane "Statutin dhe Akt -Themelimin e Shoqerise "**I.C. ALBANIAN REAL ESTATE GROUP**" shpk ", bashkëlidhur te hartuar jashte zyres noteriale.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

FLORIAN F. HOXHA

REPERTORIO N. 24928 1

PROCURA SPECIALE

REPUBBLICA ITALIANA

L'anno duemilaventitre il giorno quindici del mese di novembre in Frosinone alla via Marco Tullio Cicerone n. 129, presso il mio studio,

Il 15/11/2023

Innanzi a me dottor Annamaria Ortolan notaio in Frosinone, iscritto nel Collegio del Distretto Notarile di Frosinone

sono presenti le signore:

**FRINO Vincenza,** nata a Castellammare di Stabia (NA) il 3 agosto 1937, residente a Castellammare di Stabia (NA), via Petraro n. 81, (FRN VCN 37M43 C129B);

**COPPOLA Evelina,** nata a Castellammare di Stabia (NA) il 10 settembre 1965, residente a Frosinone (FR), via Casilina Nord n. 169, (CPP VLN 65P50 C129L).

Dette comparenti, cittadine italiane, della cui identità personale io notaio sono certo, mi richiedono di ricevere il presente atto, con il quale nominano e costituiscono loro Procuratore Speciale e per quanto infra generale il signor:

**COPPOLA Antonio**, nato a Castellammare di Stabia (NA) il 25 luglio 1970, residente a Castellamare di Stabia (NA), via Petraro n. 81, (CPP NTN 70L25 C129U);

affinché nell'interesse di esse mandanti ed in loro nome, vece e conto, unitamente al costituito mandatario che inter-

verrà anche in proprio, ed ad altri aventi causa, abbia ad intervenire all'atto costitutivo della società a responsabilità limitata "**I.C. ALBANIAN REAL ESTATE GROUP SHPK**" in Albania, avente capitale sociale di euro 241.971,00 (leke 25588431,99) sottoscrivendo quote nella misura totale che riterrà più opportune del 50% (pari a due quote della percentuale di 16,66% ed una di 16,68%) per un totale di € 120.985,00 di cui € 51.744,65 in beni immobili ed il residuo in capitale da sottoscrivere € 69.240,85 e versandone il relativo controvalore parziale, da liberarsi mediante conferimento dei seguenti beni immobili suscettibile di valutazione economica siti in Comune di Castellammare di Stabia (Na) e sono identificati nel catasto fabbricati e precisamente:

Foglio 4, particella 2707, subalterno 2, categoria A3 classe 1 consistenza 4 rendita catastale 278,89;

Foglio 4, particella 2707, subalterno 3, categoria C2;

Foglio 4, particella 2707, subalterno 4, categoria F3.

Nel catasto terreni:

Foglio 4, particella 2706 sup. 180 mq;

Foglio 4, particella 2708 sup. 1.178 mq;

Foglio 4, particella 1607 sup. 417 mq.

Tutti beni sopra elencati relativi al comune di Castellammare di Stabia (NA) sono stati indicati nella dichiarazione di successione Protocollo Telematico: 23101118572060492 (Estremi di registrazione dichiarazione: Volume:88888, Nume-

ro:442847 Anno:2023 Presentata il 11/10/2023 Competenza: UFFICIO TERRITORIALE ATTI PUBBLICI, SUCCESSIONI E RIMBORSI IVA NAPOLI II - TE9 e sono stati valutati con perizia Giurata dal Geom. Ciro Scala in data 20/10/2023.

Nel capitale della società verranno conferiti i seguenti beni immobili siti in Comune di Terracina (LT) identificati nel catasto fabbricati di Terracina (Lt) e precisamente:

Abitazione del tipo civile nel Comune di Terracina (Lt)

- N.C.E.U. Foglio 190 particella 646 sub 2 categoria A/2 classe 4a consistenza vani 6 rendita catastale € 712,71 Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Piano Terra

Locale deposito nel Comune di Terracina (Lt)

- N.C.E.U. Foglio 190 particella 646 sub 3 categoria C/2 classe 1a consistenza Mq 295 rendita catastale € 777,01 Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Piano Terra

Locale deposito (cantina) nel Comune di Terracina (Lt)

- N.C.E.U. Foglio 190 particella 646 sub 4 categoria C/2 classe 1a consistenza Mq 13 rendita catastale € 34,24 Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Piano S1 A;

Comune di Terracina (LT) e sono identificati nel catasto Terreni e precisamente:

- N.C.T. Foglio 190 particella 78 qualità seminativo classe 3a consistenza are 24 e centiare 50 R.D. € 24,29 R.A. € 21,51;

- N.C.T. Foglio 190 particella 109 qualità seminativo classe

3a consistenza are 01 e centiare 10 R.D. € 1,09 R.A. € 0,97;

- N.C.T. Foglio 190 particella 112 qualità seminativo classe 3a consistenza are 02 e centiare 60 R.D. € 2,58 R.A. € 2,28;
- N.C.T. Foglio 190 particella 456 qualità vigneto classe 4a consistenza are 03 e centiare 40 R.D. € 2,84 R.A. € 2,55;
- N.C.T. Foglio 190 particella 457 qualità vigneto classe 4a consistenza are 49 e centiare 10 R.D. € 41,08 R.A. € 36,77;
- N.C.T. Foglio 190 particella 649 qualità seminativo classe 3a consistenza are 50 e centiare 87 R.D. € 63,05 R.A. € 44,66;

Tutti beni sopra elencati relativi al comune di Terracina (LT) sono stati indicati e valutati con perizia Giurata dal Geom. Massimiliano Chiappini del collegio dei Geometri di Frosinone in data 13/07/2023, e saranno conferiti dal socio sig. Gianluigi IZZO, nato a Latina il 12/05/1987.

Il nominato Procuratore è autorizzato a meglio definire in sede di atto costitutivo, la denominazione, la sede legale, il capitale da conferire e l'oggetto sociale, la durata della costituenda società, ad approvare lo statuto che disciplinerà la vita sociale, a procedere alla nomina dell'Organo Amministrativo e dell'eventuale Organo di Controllo ed a convenire ogni patto, clausola o condizione che riterrà opportuna o conveniente, ivi compreso il versamento del capitale sociale per la parte eccedente il conferimento immobiliare.

Il tutto con promessa di rato e valido sotto gli obblighi di

legge.

E richiesto io notaio ho ricevuto il presente atto da me redatto e letto alle comparenti, le quali riconoscendolo conforme alla propria volontà lo approvano e con me notaio lo sottoscrivono nei fogli di cui si compone.

Occupa due fogli scritti da me notaio parte di mia mano e parte da persona di mia fiducia con mezzo meccanico a nastro con inchiostro indelebile ai sensi di legge, su quattro intere facciate e quanto sin qui della quinta.

**APOSTILLE**
**(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)**

1. Paese **ITALIA**

Il presente atto pubblico

2. è stato firmato da ANNAMARIA ORTOLAN
3. operante in qualità di NOTAIO
4. è munito del sigillo/bollo di ORTOLAN ANNAMARIA DI MARIO NOTAIO IN FROSINONE

Attestato

5. in **FROSINONE** 6. il 16 NOV. 2023
7. da **PROCURA DI FROSINONE (ITALIA)**
8. col numero 521/23 REG. APOSTILLE
9. Sigillo / bollo

10. Firma

Il Sostituto Procuratore
Dott. Alessandro PICCHI

**NR. REPERTORI 249281**

**PROKURË E POSAÇME**
**REPUBLIKA ITALIANE**

Më datë 15 Nentor 2023 në Frosinone në Via Marko Tullio Cicerone nr. 129, pranë Studios time më 15/11/2023 perpara meje Dt. Annamaria Ortolan Noter në Frosinone, regjistruar në Kolegjin Noterial të Frosinone-s, u paraqitën Zonjat:
**FRINO Vincenza** lindur ne Castellammare di Stabia (NA), më 3 gusht 1937, banuese ne Castellammare di Stabia(NA) Via Petraro nr. 8, kodi fiskal (FRN VCN 37M43 C129B),

**COPPOLA Evelina**, lindur në Castellammare di Stabia (NA), më 10 Shtator 1965, banuese ne Frosinone (FR) Via Casilina nr.169,kodi fiskal (CPP VLN 65P50 C129L),

Shtetasit italianë të paraqitur për identitetin personal të të cilëve unë, noteri, jam i sigurt, më kërkuan këtë akt me të cilin emërojne si Perfaqesues të Posaçëm të tyre Zotin :

**COPPOLA Antonio,** lindur në Castellammare di Stabia (NA), më 25 Korrik 1970, banues në Castellammare di Stabia (NA) Via Petraro nr. 81,kodi fiskal (CPP NTN 70L25 C129U),

në mënyrë që në emër dhe për llogari të tyre të jetë i autorizuar të kryeje veprimet e mëposhtme: të nderhyje në aktet e themelimit te Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **«I.C. ALBANIAN REAL ESTATE BGROUP SHPK»** në Shqipëri me kapital aksionar në Euro 241.971,00 (25588431,99 lek) duke nënshkruar kuota në shumën totale që i gjykon më të përshtatshmet prej 50% (e barabartë me dy kuota të përqindjes 16.66% dhe tjetra prej 16.68%), për nje total prej Euro 120.985,00 nga të cilat 51.744,65 në pasuri të paluajtshme dhe kapitali i mbetur për t'u nënshkruar prej 69.240,85 euro dhe duke paguar vlerën e pjesshme relative, të lirohen nëpërmjet transferimit të pasurive të paluajtshme të mëposhtme që i nënshtrohen vlerësimit ekonomik që ndodhen në Komunën Castellammare di Stabia (NA) dhe janë identifikuar në regjistrin kadastral të ndërtesave dhe konkretisht:
Fletë 4, parcela 2707, numër 2, kategoria A3, klasi 1 konsistenca 4 të ardhura kadastrale 278,89 ;
Fletë 4, parcela 2707, numër 3, kategoria C2;
Fletë 4, parcela 2707, numër 4, kategoria F3.
Në regjistrin kadastral të tokave :
Fletë 4, parcela 2706 sip. 180 m2 ;
Fletë 4, parcela 2708 sip. 1.178 m2;
Fletë 4, parcela 1607 sip. 417 m2.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PËRKTHYESE ZYRTARE
Arda A. Gruçka
TRADUTTORE UFFICIALE
Përkthyese e njohur nga Min. Drejtësisë

Të gjitha pasuritë e listuara më sipër në lidhje me komunën e Castellammare di Stabia (NA) janë treguar në deklaratën e trashëgimisë Protokolli Elektronik: 23101118572060492 (Detajet e regjistrimit të deklaratës: Vëllimi: 88888, numri 442847 Viti: 2021/2021/2021/2021/2021/2021/2021/2021/2021/2020 ZYRA TERRITORIALE AKTE PUBLIKE, TRASHËGIMITË DHE RIMBURSIMET E TVSH-së NAPOLI II - TE9 dhe janë vlerësuar me një raport vlerësimi të betuar nga Gjeom. Ciro Scala më 20/10/2023.

Pasuritë e paluajtshme të mëposhtme, të vendosura në Komunën e Terracina-s (LT), të identifikuara në regjistrin kadastral së Terracina-s (Lt) do të kontribuohen në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:
Banesë e llojit civil në Komunën e Terracina-s (Lt)
- N.C.E.U. Fletë 190 parcela 646 sub 2 kategoria A/2 klasa 4a konsistenca dhoma 6, të ardhura kadastrale 712,71 € Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Kati Përdhe
Ambjent Depo në Komunën e Terracina-s (Lt)
- N.C.E.U. Fletë 190 parcela 646 sub 3 kategoria C/2 klasi, konsistenca 295 m2, të ardhura kadastrale 777,01 € Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Kati Përdhe
Ambjent Depo (bodrum) në Komunën e Terracina-s (Lt)
- N.C.E.U. Fletë 190 parcela 646 sub 4 kategoria C/2 klasa, konsistenca 13 m2, të ardhurat kadastrale 34,24 €, Via Strada Regionale 148 Pontina, snc Kati S1 A;
Komuna e Terracinës (LT) dhe janë identifikuar në Regjistrin kadastral të Tokave, përkatësisht:
- N.C.T. Fletë 190 parcela 78 cilësia e tokës arë, klasi 3a, konsistenca 24 are dhe 50 centiare R.D. 24,29 € R.A. 21,51 €;
- N.C.T. Fletë 190 parcela 109 cilësia e tokës arë, klasi 3a, konsistenca 01 are dhe 150 centiare R.D. 1,09 € R.A. 0,97 €;
- N.C.T. Fletë 190 parcela 112 cilësia e tokës arë, klasi 3a, konsistenca 02 are dhe 60 centiare R.D. 2,58 € R.A. 2,28 €;
- N.C.T. Fletë 190 parcela 456 cilësia e tokës vreshtëri, klasi 4a, konsistenca 03 are dhe 40 centiare R.D. 2,84 € R.A. 2,55 €;
- N.C.T. Fletë 190 parcela 457 cilësia e tokës arë, klasi 4a, konsistenca 49 are dhe 10 centiare R.D. 41,08 € R.A. 36,77 €;
- N.C.T. Fletë 190 parcela 78 cilësia e tokës arë, klasi 3a, konsistenca 50 are dhe 87 centiare R.D. 63,05 € R.A. 44,66 €;

Të gjitha pasuritë e listuara më sipër në lidhje me komunën e Terracinës (LT) janë treguar dhe vlerësuar me një vlerësim të betuar nga Gjeom. Massimiliano Chiappini i Kolegjit të Gjeodetëve të Frosinone më 13/07/2023, dhe do të jepen nga ortaku z. Gianluigi IZZO, i lindur në Latina më 12/05/1987.
Përfaqësuesi i emëruar është i autorizuar të përcaktojë më mirë në aktin e themelimit, emrin, selinë, kapitalin që do të kontribuojë dhe qëllimin e shoqërisë, kohëzgjatjen e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËRKTHYESE ZYRTARE Arda A. Gruçka TRADUTTORE UFFICIALE Përkthyese ... Min. Drejtësisë

shoqërisë që do të krijohet, të miratojë statutin që do të rregullojë jetën e shoqërisë, të procedojë me emërimin e Organit Administrativ dhe të çdo Organi Mbikëqyrës dhe të bjerë dakord për çdo marrëveshje, klauzolë apo kusht që e gjykon të nevojshme ose të përshtatshme, duke përfshirë pagesën e kapitalit themeltar për pjesën që tejkalon kontributin e pasurisë së paluajtshme.
Të gjitha me premtim ratifikimi dhe të vlefshmërisë sipas detyrimeve ligjore.
Dhe me kërkesë, unë noteri mora këtë akt të përpiluar dhe lexuar palëve të paraqitura, të cilët, duke e njohur atë në përputhje me vullnetin e tyre, e miratuan dhe bashkë me mua, noterin, e nënshkruan në fletët është plotësuar.
Zë dy fletë të shkruara nga unë, noteri, pjesërisht në dorën time dhe pjesërisht nga një person që i besoj, me një mjet mekanik shiriti me bojë të pashlyeshme, në përputhje me ligjin, në katër anët e tëra dhe deri këtu në të pestën.

Emer Mbiemër

Noteri
Firma, Vula

**APOSTILE**
**(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)**

1. Shteti: **ITALI**

Ky akt publik

2. Është nënshkruar nga: **ANNAMARIA ORTOLAN**
3. Veprues nën cilësinë e **NOTERIT**
4. Mban stampën/vulën e **ORTOLAN ANNAMARIA DI MARIO NOTER NË FROSINONE**

Vërtetuar

5. Në **FROSINONE**
6. Më **16 NËNTOR 2023**
7. Nga **PROKURORIA E FROSINONE-s (ITALI)**
8. Nën numrin **521/23 REGJ. APOSTILE**
9. Stampa/Vula
10. Firma

Zëvëndës Prrokurori i Republikës
**(Dr. Alessandro PICCHI)**
*(firmë vulë)*

Deklarohet se ky përkthim është në përputhje me tekstin origjinal në gjuhën italiane dhe është kryer nga përkthyesi zyrtar i miratuar nga Ministria e Drejtësisë:

ARDA A. GRUÇKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA

V2023011710095373578

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE

DATE 24/11/2023
NR REP 1714

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 24/11/2023, para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES**: Arda Gruçka, atësia Avni, amësia Katerina, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Xhafzotaj; Nd. 19; Rrashbull; Xhafzotaj; 2021; Durrës, lindur më 25/03/1988, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035765696 dhe nr. personal I85325080J .

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Prokure Italiane Nr.249281 repertori e hartuar prane Noter Annamaria Ortolan ne Frosinone", nga gjuha Italiane në gjuhën shqipedhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**
FLORIAN F. HOXHA